 - (ii) aksioni, letrave me vlere, interesave te bashkepronesise, dhe forma te tjera te pjesmarrjes ne pasuri, obligacioneve, detyrimeve dhe forma te tjera te interesave te huave, ne nje shoqeri;
 - (iii) te drejtave kontraktuale, te tilla si kontrata objektesh me çeles ne dore, kontrata menaxhimi apo ndertimi, kontrata prodhimi apo te ndarjes te te ardhurave, koncesione, ose kontrata te tjera te ngjashme;
 - (iv) pasurise se prekshme, perfshire pasurine e patundshme; dhe pasurise se paprekshme, perfshire te drejta te tilla si dhenie me qera, hipotekat, franshizen dhe pengjet;
 - (v) pronesise intelektuale, duke perfshire:
 - te drejten e autorit dhe te drejta qe lidhen me te,
 - patentat,

- te drejta mbi varietetet e bimeve,
 - dizajnet industriale,
 - te drejta mbi projektet e gjysem-perçuesave,
 - sekretet tregtare, perfshire know-how dhe informacionet konfidenciale te tregtise,
 - markat tregtare dhe te sherbimit, dhe
 - emra tregtare; dhe
- (vi) te drejta te dhena ne pajtim me ligjin, te tilla si licencat dhe lejet;
- (e) "investim i mbuluar" nenkupton nje investim te nje shtetasi ose shoqerie te njeres Pale ne territorin e Pales tjeter;
- (f) "ndermarrje shteterore" nenkupton nje shoqeri ne pronesi ose te kontrolluar nepermjet interesave te pronesise, nga njera Pale;
- (g) "autorizim investimi" nenkupton nje autorizim qe jepet nga Autoriteti i Investimeve te Huaja i njeres Pale per nje investim te mbuluar apo nje shtetas apo shoqeri e Pales tjeter;
- (h) "marreveshje investimi" nenkupton nje marreveshje te shkruar midis autoriteteve kombetare te njeres Pale dhe nje investimi te mbuluar ose nje shtetasi ose nje shoqerie te Pales tjeter e cila
- (i) jep te drejta ne lidhje me burimet natyrore ose pasuri te tjera qe kontrollohen nga autoritetet kombetare dhe,
 - (ii) mbeshtet investimin, shtetasin ose shoqerine ne krijimin ose sigurimin e nje investimi te mbuluar.
- (i) "Konventa ICSID" nenkupton Konventen mbi Zgjidhjen e Mosmarreveshjeve mbi Investimet midis Shteteve dhe Shtetasve te Shteteve te tjere, bere ne Washington me 18 Mars 1965.
- (j) "Qender" nenkupton Qendren Nderkombetare per Zgjidhjen e Mosmarreveshjeve mbi Investimet te vendosur nga Konventa e ICSID; dhe
- (k) "Rregullat e Arbitrazhit UNCITRAL" nenkupton Rregullat e Arbitrazhit te Komisionit te Kombeve te Bashkuara mbi Ligjin e Tregtise Nderkombetare.

NENI II

TRAJTIMI I INVESTIMIT

1. Ne lidhje me krijimin, pervetesimin, zgjerimin, drejtimin, udheheqjen, aktivitetin dhe shitjen ose dispozita te tjera

te investimeve te mbuluara, secila Pale do te akordoje trajtim jo me pak te favorshem se sa ai qe ajo i akordon, ne situata te ngjashme, investimeve ne territorin e saj, shtetasve ose shoqerive te saj (ketu me poshte "Trajtim Kombetar") ose investimeve ne territorin e saj te shtetasve ose shoqerive te nje vendi te trete (ketu me poshte "Trajtimi i Kombit me te Favorizuar), cili do qofte me i favorshmi (Ketu me poshte "Trajtimi Kombetar dhe i Kombit me te favorizuar"). Sejcila Pale do te siguroje qe ndermarrjet e saja shteterore, ne sigurimin e mallrave ose sherbimeve te tyre, te akordojne trajtim kombetar dhe te kombit me te favorizuar per investimet e mbuluara.

2. (a) Njera Pale mund te miratoje ose te ruaje perjashtime lidhur me detyrimet e paragrafit 1 ne sektoret ose ne lidhje me ceshtjet te specifikuara ne Aneksin e ketij Traktati. Ne miratimin e nje perjashtimi te tille, njera Pale nuk mund te kerkoje heqjen, pjeserisht apo teresisht, te investimit te mbuluar ekzistues ne kohen kur perjashtimi do te behet efektiv.
- (b) Detyrimet e paragrafit 1 nuk zbatohen per procedurat qe parashikohen ne Marreveshjet Multilaterale te perfunduara nen vemendjen e Organizates Boterore te Pronesise Intelektuale ne lidhje me pervetesimin ose ruajtjen e te Drejtave te Pronesise Intelektuale.
3. (a) Sejcila Pale ne çdo kohe, do t'i akordoje investimeve te mbuluara, nje trajtim te drejte dhe te barabarte dhe nje mbrojtje e sigurim te plote dhe ne asnje rast nuk do te akordoje trajtim me pak te favorshem se sa ai qe kerkohet nga e Drejta Nderkombetare.
- (b) Asnjera nga Palet nuk do te demtoje me asnje menyre, me masa te pa arsyeshme dhe diskriminuese drejtimin, udheheqjen, aktivitetin, dhe shitjen ose dispozita te tjera te investimeve te mbuluara.
4. Sejcila Pale do te siguroje mjete efektive per mbrojtjen e reklamimeve dhe per forcimin e te drejtave lidhur me investimet e mbuluara.
5. Sejcila Pale siguron qe ligjet, rregullat, praktikat administrative dhe procedurat e aplikimit ne pergjithesi, dhe vendimet gjyqesore qe kane te bejne me ose ndikojne ne investimet e mbuluara, do te publikohen menjehere ose do te vihen ne dispozicion per publicitet.

NENI III

SHPRONESIMI

1. Asnjera Pale nuk do te shpronesoje apo shtetezoje nje

investim te mbuluar qofte direkt apo indirekt, nepermjet masave te barazvlefshme me shpronesimin apo shtetezimin ("shpronesim") pervec se per qellime publike, ne menyre jo diskriminuese, nepermjet nje pagese te menjehereshme, nje kompensimi te pershtatshem dhe efektiv, dhe ne perputhje me proceduren ligjore dhe me parimet e pergjithshme te trajtimit te parashikuara ne Nenin II(3).

2. Kompensimi do te paguhet pa vonese; do te jete ekuivalent me vleren e sakte te tregut te investimit te shpronesuar menjehere perpara se te ndermerrej veprimi i shpronesimit ("data e shpronesimit"); dhe te jete plotesisht i realizueshem dhe lirisht i transferueshem. Vlera e pranueshme e tregut nuk do te pasqyroje ndonje ndryshim ne vlere, qe vjen per shkak se veprimi i shpronesimit, eshte bere i njohur para "dates se shpronesimit".
3. Ne rast se vlera e sakte e tregut eshte njesuar ne nje monedhe lirisht te perdorshme, kompensimi i paguar nuk do te jete me i vogel se vlera e sakte e tregut ne daten e shpronesimit, plus interesin ne nje perqindje tregtare te arsyeshme per kete monedhe, qe rritet nga data e shpronesimit deri ne daten e pageses.
4. Ne rast se vlera e sakte e tregut eshte njesuar ne nje monedhe e cila nuk eshte lirisht e perdorshme, kompensimi i paguar i konvertuar ne monedhen e pageses me kursin e shkembimit te tregut qe mbizoteron ne daten e pageses, nuk do te jete me i vogel se:
 - (a) Vlera e sakte e tregut ne daten e shpronesimit, e konvertuar ne nje monedhe lirisht te perdorshme me kursin e shkembimit te tregut te kembimit qe mbizoteron ne ate date, plus
 - (b) Interesin, ne nje perqindje tregtare te arsyeshme per ate monedhe lirisht te perdoreshme, te rritur nga data e shpronesimit deri ne daten e pageses.

NENI IV

KOMPENSIMI PER DEMET E SHKAKTUARA NGA LUFTA DHE NDODHI TE NGJASHME

1. Sejcila Pale do te akordoje "trajtim kombetar dhe te kombit me te favorizuar" per investimet e mbuluara persa i perket çdo mase qe lidhet me humbjet qe investimet pesojne ne territorin e saj, per shkak te luftes ose konflikteve te tjera te armatosura, revolucionit, gjendjes se emergjences kombetare, kryengritjeve, turbullirave civile, ose ndodhive te ngjashme.
2. Sejcila Pale do te akordoje kthimin ose do te paguaj

kompensimin ne perputhje me paragrafet 2 deri 4 te Nenit III, ne rastet kur investimet e mbuluara pesojne humbje ne territorin e saj, per shkak te luftes ose te nje konflikti tjeter te armatosur, revolucionit, gjendjes se emergjences kombetare, kryengritjeve, turbullirave, ose ndodhive te ngjashme qe rezultojne nga:

- (a) rekuizimi i nje pjese apo i te gjithe ketij investimi nga forcat ose autoritetet e Pales, ose
- (b) shkaterrimi i nje pjese ose i te gjithe ketij investimi nga forcat ose autoritetet e Pales, qe nuk kerkohej si domosdoshmeri e situates.

NENI V

TRANSFERIMET

1. Çdo Pale do te lejoje qe te gjitha transferimet, qe kane te bejne me nje investim te mbuluar, te behen lirisht dhe pa vonese brenda dhe jashte territorit te vet. Keto transferime perfshijne:
 - (a) kontributet fillestare apo shtese te kapitalitqe ka lidhje me investimin;
 - (b) fitimet, dividendet, rritjet e kapitalit, dhe fitimet nga shitja e nje pjese ose te gjithe investimit ose nga likuidimi i pjeseshem ose i plote i investimit;
 - (c) interesat, pagesat per komisionet, shperblimet per menaxhim dhe asistence teknike dhe shperblime te tjera;
 - (d) pagesa e bera ne baze te nje kontrate, duke perfshire nje marreveshje huaje; dhe
 - (e) kompensimin sipas Nenit III dhe IV, dhe pagesat qe lindin nga nje mosmarreveshje investimi.
2. Çdo Pale do te lejoje qe transferimet te behen ne nje valute lirisht te perdorshme me kursin e shkembimit te tregut qe mbizoteron ne daten e transferimit.
3. Çdo Pale do te lejoje transferimin ne natyre te behet sic autorizohet ose specifikohet ne nje autorizim investimi, ne nje marreveshje investimi, ose ne nje marreveshje tjeter te shkruar midis nje Pale dhe nje investimi te mbuluar ose nje shtetasi ose shoqerie te Pales tjeter.
4. Pamvaresisht nga sa parashikohet ne paragrafet 1 deri tek 3, nje Pale mund te ndaloje nje transferim nepermjet zbatimit te drejte, jo-diskriminues dhe me mirebesim te ligjeve te saj, qe kane te bejne me :

- (a) falimentimin, paaftesine per pagese ose mbrojtjen e te drejtave te kreditoreve;
- (b) emetimin, tregetimin ose trajtimin e letrave me vlere;
- (c) veprimet kriminale ose penale; ose
- (d) zbatimin e perpikthe te urdhrave ose gjykimeve ne procedurat gjyqsore.

NENI VI

ZBATIMI I KERKESAVE

Asnjera nga Palet nuk do te vendose ose imponoje si kusht asnje kerkese per krijimin, pervetesimin, zgjerimin, drejtimin, udheheqjen ose vazhdimin e nje investimi te mbuluar, (perfshire çdo angazhim ose siper marrje ne lidhje me marrjen e nje leje qeveritare ose autorizimi qeveritar):

- (a) te vendose nje nivel ose perqindje te veçante te permbajtjeve me origjine vendase, ose te bleje, perdore ose t'u jape preference prodhimeve ose sherbimeve me origjine vendase ose nga çdo burim vendas;
- (b) te kufizojë importet per prodhimet ose sherbimet e investimit ne lidhje me nje volum ose vlere te veçante te prodhimit, eksportit ose te ardhurave nga shkembimet me jashte;
- (c) te eksportoje nje lloj, nivel ose perqindje te veçante te produkteve ose sherbimeve, si ne pergjithesi ashtu edhe ne nje rajon tregtar specifik;
- (d) te kufizojë shitjet e produkteve ose sherbimeve nga investimi ne territorin e Pales ne lidhje me nje volum ose vlefte te veçante te prodhimit, eksporteve ose te ardhurat nga shkembimi me jashte;
- (e) te transferojë teknologji, nje proces prodhimi, ose njohuri te tjera pronesia nje shtetasi ose nje shoqerie ne territorin e njeres Pale, perveçse ne pajtim me nje urdher, angazhim ose siper marrje qe imponohet nga nje gjykate, gjykate administrative, ose organ konkurues per te ndrequr nje shkelje te dukshme ose te provuar me gjyq te ligjeve te konkurrences; ose
- (f) per te kryer nje lloj, nivel ose perqindje te veçante te kerkimeve dhe zhvillimit ne territorin e Pales.

Keto kërkesa nuk perbejne kushte per perftim ose per perfitim te vazhdueshem te nje avantazhi.

NENI VII

HYRJA, QENDRIMI I PERKOHSHEM DHE PUNESIMI I TE HUAJVE

1. (a) Ne perputhje me ligjet e veta ne lidhje me hyrjen dhe qendrimin e te huajve, sejcila Pale, , do te lejoje hyrjen dhe qendrimin ne territorin e saj te shtetasve te Pales tjeter, me qellim krijimin, zhvillimin, administrimin ose keshillimin ne veprimtarine e nje investimi ne te cilin ata, ose nje shoqeri e Pales tjeter qe i puneson ata, ka angazhuar ose eshte ne procesin e angazhimit te nje shume te rendesishme kapitali ose burimesh te tjera.
- (b) Asnjera nga Palet qe lejon hyrjen sipas paragrafit 1 (A), nuk do te kerkoje nje certifikate prove pune, ose procedura te tjera me efekt te ngjashem, ose te zbatoje ndonje kufizim numerik.
2. Sejcila Pale do te lejoje qe per investimet e mbuluara te angazhohet personel drejtues i kualifikuar, sipas zgjedhjes se tyre, pamvaresisht nga shtetesia.

NENI VIII

KONSULTIMET

Palet u muarren vesh te konsultohen menjehere, me kërkesen e njerës prej tyre, per zgjidhjen e çdo mosmarreveshje ne lidhje me Traktatin, ose te diskutojne çdo çështje lidhur me interpretimin ose zbatimin e Traktatit ose per realizimin e objektivave te Traktatit.

NENI IX

ZGJIDHJA E MOSMARREVEESHJEVE MIDIS NJE PALE DHE SHTETASIT OSE SHOQERISE TE PALES TJETER

1. Per qellimet e ketij Traktati, nje mosmarreveshje investimi eshte nje mosmarreveshje midis nje Pale dhe nje shtetasi ose nje shoqerie te Pales tjeter qe lind nga, ose qe lidhet me nje autorizim investimi, me nje marreveshje investimi

ose me nje shkelje te deklaruar te çdo te drejte te dhene, te krijuar ose te njohur nga ky Traktat, qe ka te beje me nje investim te mbuluar.

2. Nje shtetas ose nje shoqeri, qe eshte Pale ne nje mosmarreveshje investimi mund t'ja shtroje mosmarreveshjen per zgjidhje njerës prej alternativave te meposhteme:
 - (a) gjykatave ose gjykatave administrative te Pales qe eshte pale ne mosmarrveshje; ose
 - (b) ne perputhje me çdo procedure te zbatueshme, te rene dakort paraprakisht per zgjidhjen e mosmarreveshjeve; ose
 - (c) ne perputhje me kushtet e paragrafit 3.
 3. (a) me kusht qe shtetasi ose shoqeria e interesuar nuk e ka paraqitur mosmarreveshjen per zgjidhje sipas paragrafit 2 (a) ose 2 (b), dhe kane kaluar tre muaj nga data e lindjes se mosmarreveshjes, shtetasi ose shoqeria e interesuar mund t'ja parashtroje mosmarreveshjen per nje zgjidhje te detyruesheme nga arbitrazhi:
 - (i) Qendres, ne se Qendra eshte e gatshme; ose
 - (ii) Zyrrave ndihmese te Qendres ne se Qendra nuk eshte e gateshme; ose
 - (iii) ne perputhje me Rregullat e Arbitrazhit te UNCITRAL; ose
 - (iv) ne rast se bihet dakort nga te dy Palet ne mosmarreveshje, ne çdo institucion tjeter arbitrazhi ose ne perputhje me çdo lloj tjeter rregullash arbitrazhi.
 - (b) Nje shtetas ose shoqeri, pamvaresisht se mund t'ja kete parashtruar mosmarreveshjen, arbitrazhit te detyrueshem sipas paragrafit 3 (a), mund te kerkoje nje ndihme te perkohshme me urdher zyrtar nga gjykata, pa perfshire pagesen e demeve, perpara gjykates juridike ose administrative te Pales qe eshte Pale ne mosmarreveshje, para percaktimit te procedures gjyqsore ose gjate saj, per mbrojtjen e te drejtave dhe interesave te tij.
4. Sejcila Pale eshte dakort t'ja parashtroje zgjidhjen e nje mosmarreveshje investimi arbitrazhit te detyrueshem , ne

perputhje me zgjedhjen e bere nga shtetasi ose shoqeria sipas paragrafit 3 (A) (I), (II) dhe (III) ose me marreveshje te perbashket te te dyja Paleve ne mosmarreveshje sipas paragrafit 3 (A) (IV). Pranimi dhe paraqitja e mosmarreveshjes nga nje shtetas ose shoqeri sipas paragrafit 3 (A) duhet te permbushe kerkesat e:

(a) Kapitullit II te Konventes se ICSID (juridiksionin e Qendres) dhe Rregullat Lehtesues Ndhimese per renien dakort me shkrim te Paleve ne mosmarreveshje; dhe

(b) Neni II i Konventes se Kombeve te Bashkuara mbi Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve te Arbitrazhit te Huaj, bere ne New York me 10 Qershor 1958 per nje "Marreveshje me Shkrim".

5. Çdo arbitrazh sipas paragrafit 3 (A) (II), (III) ose (IV) do te behet ne nje Shtet qe eshte Pale e Konventes se Kombeve te Bashkuara mbi Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve te Arbitrazhit te Huaj, bere ne New York me 10 Qershor 1958.

6. Çdo vendim arbitrazhi ne perputhje me kete Nen do te jete perfundimtar dhe i detyrueshem per Palet ne mosmarreveshje. Sejcila Pale do te realizoje pa vonese kushtet e ketij vendimi dhe do te siguroje ne territorin e saj zbatimin e ketij vendimi.

7. Ne çdo proçedure qe ka te beje me nje mosmarreveshje investimi, nje Pale nuk mund te perdore si mbrojtje, kunderpadine, te drejten per te anuluar apo çdo arsye tjeter, per nje demshperblim apo kompensim per te gjithë apo nje pjese te demeve te deklaruara qe eshte marre ose do te merret sipas nje kontrate sigurimi ose garancie.

8. Per qellimet e Nenit 25(2) (B) te Konventes se ICSID dhe te ketij Neni , nje shoqeri e njeres Pale e cila menjehere para ndodhjes se ngjarjes ose ngjarjeve qe shkaktuan mosmarreveshjen e investimit, ishte nje investim i mbuluar, do te trajtohet si shoqeri e Pales tjeter.

NENI X

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE MIDIS PALEVE

1. Çdo mosmarreveshje midis Paleve që ka të bëjë me inter pretimin ose zbatimin e Traktatit, e cila nuk është zgjidhur nepermjet konsultimeve apo kanaleve të tjera diplomatike, do t'i nënshtrohet me kërkesën se sejciles Pale një gjykatë arbitrazhi për vendim detyrues në përputhje me rregullat e zbatueshme të së drejtes nderkombetare. Në mungesë të një marreveshjeje nga palet në kundërshtim, do të veprojnë Rregullat e Arbitrazhit të UNCITRAL, me përjashtim të rasteve kur këta rregulla (A) janë ndryshuar nga Palet ose (B) janë ndryshuar nga arbitrat në rast se asnjëra nga Palet nuk kundërshton ndryshimet e propozuara.
2. Brenda dy muajve nga marrja e kërkesës, çdo Pale do të caktojë një arbiter. Dy arbitrat do të caktojnë një arbiter të tretë si Kryetar, i cili duhet të jetë shtetas i një vendi të tretë. Rregullat e Arbitrazhit UNCITRAL që zbatohen për caktimin e antarëve pjesëmarrës të komisionit prej 3 anëtarësh do të zbatohen sipas parimit "mutatis mutandis" për caktimin e komisionit arbitral, përveç rastit kur autoriteti caktohet sipas ketyre rregullave do të jetë Sekretari i Përgjithshëm i "Qendres".
3. Në qoftë se nuk është rënë dakord ndryshe, të gjitha parashtresat për gjykim dhe të gjitha seancat duhet të perfundohen brenda gjashtë muajve nga data e zgjedhjes së arbitrit të tretë, dhe komisioni arbitral duhet t'a japë vendimin e vet brenda dy muajve nga data e parashtresës perfundimtare apo nga data e mbylljes së seancave, ciladoqoftë nga ato e fundit.
4. Shpenzimet për kryetarin dhe arbitrat e tjere dhe shpenzimet e tjera të procedurave do të paguhën në mënyrë të barabartë nga Palet. Megjithatë, Komisioni arbitral, sipas gjykimit të vet, mund të urdherojë që njëra nga Palet të paguajë një pjesë me të madhe të shpenzimeve.

NENI XI

MBROJTJA E TE DREJTAVE

Ky Traktat nuk do te cenoje asnje nga praktikat e meposhteme qe u japin investimeve te mbuluara nje trajtim me te favorshem nga ai i dhene nga ky Traktat:

- (a) Ligjet dhe rregullat, praktikat administrative apo procedurat, apo vendimet administrative ose gjyqesore te njeres Pale;
- (b) Detyrimet ligjore nderkombetare; ose
- (c) Detyrimet e marra persiper nga njera Pale, duke perfshire ato qe permbahen ne nje autorizim investimi apo ne nje marreveshje investimi.

NENI XII

REFUZIMI I PERFITIMEVE

Secila Pale rezervon te drejten t'i mohojte nje shoqerie te Pales tjeter perfitimet nga ky Traktat ne rast se shtetasit e nje vendi te trete zoterojne ose kontrollojne shoqerine dhe

- (a) Pala e cila mohon te drejten nga perfitimet nuk mban marredhenie ekonomike normale me vendin e trete; ose
- (b) Shoqeria nuk ka aktivitete te rendesishme biznesi ne territorin e Pales sipas ligjeve te se ciles eshte themeluar ose organizuar.

NENI XIII

TAKSIMI

1. Asnje nga dispozitat e ketij Traktati nuk do te imponojne detyrime lidhur me ceshtjet e taksave pervec se :

- (a) Nenet III, IX dhe X do te zbatohen lidhur me shpronesimin; dhe
 - (b) Neni IX do te zbatohet lidhur me nje marreveshje investimi ose nje autorizim investimi.
2. Nje shtetas ose nje shoqeri qe verteton ne nje mosmarreveshje investimi se nje çeshtje taksimi ka perfshire nje shpronesim, mund ta parashtroje kete mosmarreveshje ne arbitrazh ne zbatim te Nenet IX (3) vetem ne rast se :
- (a) Shtetasi ose shoqeria e interesuar i eshte drejtuar se pari autoriteteve kompetente te taksimit te te dyja Paleve ne se çeshtja e problemit te taksave perfshin nje shpronesim; dhe
 - (b) Autoritetet kompetente te taksimit nuk kane percaktuar se bashku, brenda nente muajve nga data e referimit te çeshtjes nga shtetasi ose shoqeria, ne se problemi nuk perfshin nje shpronesim.

NENI XIV

MASA QE NUK PENGOHEN NGA KY TRAKTAT

1. Ky Traktat nuk do te pengoje nje Pale qe te zbatoje masa te nevojshme per plotesimin e detyrimeve te saja qe kane te bejne me ruajtjen apo vendosjen e paqes apo sigurimit nderkombetar, apo mbrojtjen e interesave te veta themelore te sigurimit.
2. Ky Traktat nuk do te pengoje nje Pale ne percaktimin e formaliteteve te veçanta lidhur me investimet e mbuluara, siç eshte kerkesa qe keto investime te krijohen ne menyre ligjore, sipas ligjeve dhe rregullave te kesaj Pale, ose nje kerkesa qe transferimet e valutes ose instrumentave te tjere monetare te raportohen, me kusht qe keto formalitete nuk do te pengojne thelbin e çdo te drejte te parashtruar ne kete Traktat.

NENI XV

APLIKIMI I KETIJ TRAKTATI PER NENDARJET POLITIKE DHE NDERMARRJET SHETERORE TE PALEVE

1. (a) Detyrimet e ketij Traktati do te zbatohen ne nendarjet politike te Paleve.

(b) Ne lidhje me trajtimin qe akordohet nga nje Shtet, Territor ose nen zoterimin e Shteteve te Bashkuara te Amerikes, trajtim kombetar do te thote trajtim jo me pak i favorshem se sa trajtimi i dhene ketu, ne situata te ngjashme, investimeve te shtetasve te Shteteve te Bashkuara te Amerikes qe jane rezidente ne te, dhe shoqerive te themeluara ligjerisht sipas ligjeve dhe rregullave te Shteteve te tjera, Territoreve ose nen zoterimin e Shteteve te Bashkuara te Amerikes.
2. Detyrimet e nje Pale sipas ketij Traktati do te zbatohen per ndermarrjen sheterore ne ushtrimin e çdo organi rregullator, administrativ ose organi tjeter qeveritar te deleguar atij nga ajo Pale.

NENI XVI

HYRJA NE FUQI, ZGJATJA DHE PERFUNDIMI

1. Ky Traktat do te hyje ne fuqi tridhjetete dite pas dates se kembimit te instrumentave te ratifikimit. Do te mbetet ne fuqi per nje afat prej dhjete vjetesh dhe do vazhdoje te jete ne fuqi deri sa te perfundohet ne perputhje me paragrafin (2). Ky do te zbatohet per investimet e mbuluara qe ekzistojne ne kohen e hyrjes se tij ne fuqi si dhe per investimet e bera apo te perftuara pas kesaj.
2. Njera Pale mund te kerkoje perfundimin e ketij Traktati ne fund te periudhes dhjete vjecare ose ne çdo kohe pas kesaj periudhe duke njoftuar me shkrim Palen tjeter nje vit perpara.
3. Per dhjete vjet nga data e shfuqizimit, te gjitha Nenet e tjera per investimet e mbuluara te krijuara ose perftuara

para dates se shfuqizimit do te qendrojne ne fuqi, pervec atyre Neneve te bera per krijimin dhe perftimin e investimeve te mbuluara.

4. Aneksi dhe Protokolli jane pjese perberese e Traktatit.

Ne deshmi si me siper, te plotfuqishmit perkates kane nenshkruar kete Traktat.

BERE ne dy kopje ne Washington me 11 Janar, 1995, ne gjuhen Angleze. Nje tekst ne gjuhen shqipe do te pergatitet dhe do te konsiderohet plotesisht autentik me shkembimin e notave diplomatike qe konfirmon perputhjen e tij me tekstin e gjuhes angleze.

PER QEVERINE E REPUBLIKES
SE SHQIPERISE

PER QEVERINE E SHTETEVE
TE BASHKUARA TE AMERIKES

A N E K S

1. Qeveria e Shteteve te Bashkuara te Amerikes mund te adoptoje ose te ruaj perjashtime ne detyrimin per te dhene trajtim kombetar ne investime te mbuluara ne sektoret ose per çeshtjet qe specifikohen me poshte:

Energjia atomike;komisioneret doganore; licencat per media-transmetim,transmetuesit e zakonshem, ose stacionet aeronautike te radios;COMSAT;subvensionet ose ndihmat, perfshire kredite e mbeshtetura nga Qeveria, garanci dhe sigurime; masa shteterore ose lokale te perjashtuara nga Neni 1102 i Marreveshjes se Tregtise se Lire te Amerikes se Veriut sipas Nenit 1108 po aty; shtrirjen e kablllove nenujore.

Trajtimi i kombit me te favorizuar do te akordohet per sektoret dhe çeshtjet e treguara me siper.

2. Qeveria e Shteteve te Bashkuara te Amerikes mund te miratoje ose te ruaj perjashtime ne detyrimin per te dhene trajtim kombetar dhe te kombit me te favorizuar ne investime te mbuluara, ne sektoret ose lidhur me çeshtjet qe specifikohen me poshte:

- Peshkim; transporti ajror dhe detar,dhe veprimtari qe lidhen me to; procese bankare, letra me vlere dhe sherbime te tjera financiare.

3. Qeveria e Shteteve te Bashkuara te Amerikes mund te pershtase ose te ruaje perjashtime ne detyrimin per te dhene trajtim kombetar ose te kombit me te favorizuar ne investime te mbuluara,me kusht qe perjashtimet ne trajtim sipas ketij traktati te mos rezultojne me pak te favorshme se sa trajtimi qe Qeveria e Shteteve te Bashkuara te Amerikes ka marre persiper ti jape sipas Marreveshjes se Tregtise se Lire te Amerikes se Veriut nje pale tjeter ne kete Marreveshje, per sektoret ose lidhur me çeshtjet e specifikuara me poshte:

- sigurimet.

4. Qeveria e Republikës së Shqipërisë mund të miratojë ose të ruajë përjashtime në detyrimin për të dhënë trajtim kombëtar ose të kombit me të favorizuar në investime të mbuluara në sektorët ose lidhur me çështjet e specifikuar më poshtë:

- pronesinë mbi token; veprimtari bankare; subvencione qeveritare.

Trajtimi i kombit me të favorizuar do të jepet në sektorët dhe çështjet e treguara më lart.

5. Sejcila Pale bie dakort të japë trajtim kombëtar në investime të mbuluara në sektorët si vijon:

- qiradhenie në tokat shtetërore për mineralet dhe për kalimin e tubacioneve.

PROTOKOLL

1. Lidhur me Nenin 8, Palet konfirmojne reciprokisht mirekuptimin e tyre qe sejcila Pale do te trajtoje çdo shkembim informacionesh konfidencial ose pronesor gjate konsultimeve, me te njejtat baza ashtu sic e ka parashikuar Pala qe sjell informacionin.
2. Lidhur me Nenin 13, Palet konfirmojne reciprokisht mirekuptimin e tyre qe asnjera nga Palet nuk ka detyrim qe te akordoje trajtim kombetar lidhur me çeshtjet e taksave, pervec se kur parashikohet ndryshe ne nje autorizim investimi ose ne nje marreveshje investimi.